



**MOS HUMB ASGJË.**

**VAKSINOÛ.**

**MBRO VETEN DHE TË TJERËT –  
PËR NJË BOTË PA FRUTH.**

**Një botë pa fruth është e mundur.**

Zvicra mbështet aspiratën e një eliminimi të fruthit në shkallë botërore. Amerika Veriore dhe Jugore, Finlanda dhe Australia, sot, falë vaksinimit, janë pa fruth. Vendet tjera skandinave, por edhe disa vende aziatike, si Japonia, Tajvani ose Koreja Jugore, janë në prag të eliminimit të fruthit. Është kohë e fundit që edhe Zvicra ta eliminojë definitivisht fruthin.

©Enti Federal për Shëndetësi (BAG)

Editor: Bundesamt für Gesundheit  
Abteilung Übertragbare Krankheiten  
CH-3003 Bern

Koha e publikimit: Tetor 2013

**VAKSINOÛ  
KUNDËR FRUTHIT  
DHE MOS HUMB  
ASGJË.**

**A jeni i vaksinuar?**



**Kush është me fruth, duhet të rrijë në shtëpi.  
[www.stopmasern.ch](http://www.stopmasern.ch)**

## SËMUNDJA

### Kush është me fruth, duhet të rrijë në shtëpi.

Fruthi është një sëmundje infektive tejet ngjitëse. Për këtë shkak, kush sëmuremi nga fruthi, duhet të rrimë në shtëpi. Simptomat nga të cilat vuajmë me këtë rast, janë të pakëndshme. Përpos kësaj, mund të shfaqen komplikime të rënda. Kush bie në kontakt me një pacient me fruth, duhet të hyjë gjithashtu në karantinë, edhe po të jetë i vaksinuar tashmë, ose po ta ketë përjetuar këtë sëmundje më parë. Që nga çasti i infeksionit, deri te shfaqja e sëmundjes, mund të kalojnë deri tre javë. Dhe gjatë kësaj kohe çdo individ mund t'i shpëtojë ndonjë gjë.



### Ç'është fruthi?

Shenjat e ftohjes, kollitja, pezmatimi i syve, temperatura dhe njollat e kuqe janë simptomat tipike të fruthit. Shpesh, ndërkaq, shfaqen dhe komplikime, si pezmatimi i veshit të mesëm, në disa raste edhe pezmatimi i mushkërive dhe i trurit (encefaliti). Mund të mbeten dhe gjymtime të caktuara, ndërsa në raste të rralla, fruthi mund të çojë deri në vdekje. Në rastin më të mirë, pacienti do të jetë sërish i shëndoshë pas rreth pesë ditësh.

### A është fruthi një sëmundje fëmijësh?

Jo. Kush nuk e ka pasur akoma fruthin, ose nuk është vaksinuar kundër tij, mund të sëmuret prej tij, pavarësisht moshës. Pos kësaj, tek të rriturit sëmundja shpeshherë ka rrjedhë më të rëndë, dhe paraqiten akoma më shpesh komplikimet e lartpërmendura.

### A është mirë nëse një fëmijë e kalon sëmundjen?

Jo. Fruthi është një sëmundje e padëmshme, dhe përbalimi i tij nuk e forcon sistemin imunitar të fëmijës. Përkundrazi: për javë të tëra pas sëmundjes sistemi imunitar mbetet i dobësuar. Vaksinimi kundër fruthit shmang efektivisht vuajtjet, komplikimet, qëndrimet spitalore dhe rastet e vdekjes. Ai pastaj mbron fëmijët dhe individët tjerë me sistem të dobët imunitar nga një sëmundje për ta akoma më të rrezikshme. Një fëmijë i sëmurë nuk bën të shkojë për një kohë të gjatë në çerdhe, kopsht fëmijësh apo në shkollë. Për këtë shkak, në një situatë të tillë kërkohet angazhimi i prindërve, pasi që këta të fundit duhet të sigurojnë përkujdesjen e fëmijës në shtëpi.

## VAKSINIMI MBRON

### Mos keni frikë nga vaksinimi kundër fruthit.

Vaksina kundër fruthit është në përdorim që prej 40 vitesh e më shumë dhe një gjë është e qartë: ajo është e sigurt dhe efektive. Vaksinimi imiton një infeksion të natyrshëm. Organizmi prodhon antitropa të cilët mbrojnë përgjithmonë nga kjo sëmundje. Efektet e mundshme anësore, sipas rregullit, janë të lehta dhe shumë më të padëmshme se sa vetë sëmundja. Rekomandohet që doza e parë të jepet në moshën 12-muajshe, ndërsa doza e dytë midis 15 dhe 24 muajsh. Të rinjtë dhe të rriturit (Nga viti 1964 dhe më pas) mund të vaksinohen në çdo kohë. Vaksinimi kundër fruthit realizohet kryesisht i kombinuar me vaksinën kundër shtytave dhe rubeolës (Vaksinimi MMR). Vaksinimi MMR është i preferueshëm edhe në rastet kur ndonjëra prej këtyre sëmundjeve tashmë është përjetuar ose kur është kryer tashmë vaksinimi kundër njëres nga këto sëmundje.

### Përse duhet vaksinuar kundër fruthit?

Fruthi shkakton rregullisht epidemi në Zvicër. Secili person i pavaksinuar mund të infektojë persona të tjerë dhe kështu mund t'i rrezikojë ata që nuk kanë imunitet. Sidomos foshnjat, personat me sistem të dobësuar imunitar dhe shtatzënat që nuk zotërojnë mbrojtje nga vaksinimi i mëparshëm ose nga përjetimi i mëhershëm i fruthit. Kësisoj, vaksinimi kundër fruthit i mbron edhe të tjerët.

**Kontrolloni statusin tuaj të vaksinimit.  
Po të jetë e nevojshme, rivaksinohuni.**

Me angazhimin tuaj mbroni veten dhe të tjerët. Lajmërohuni te mjeku/mjekja juaj ose këshillohuni në një barnatore.

PS. Për të gjithë ata që do të vaksinohen tani kundër fruthit, vaksinimi MMR deri në fund të vitit 2015 do të jetë i liruar nga franshisa (kjo vlen për të gjithë personat nga viti 1964 e më pas).